

Sfidat e zbatimit të ligjit të Efiçencës së Energjisë



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të projektit “I-M-P-akt – Koalicioni qytetar për ndikimin, monitorimin dhe promovimin e procesit të integritit europian të Shqipërisë”.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përketin tërësisht autorëve.

Përgatiti:

Ing. Hysni Laçi

Ing. Aheron Hizmo

Bashkëpunuan:

Msc. Gjergj Simaku

Ing. Alma Saraçi

Redaktoi: Erjon Tase

Lista e shkurtimeve

AEE - Agjensia për Efiçencën e Energjisë

AKBN - Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore

BRE-Burimet e Rinovueshme të Energjisë

EE- Efiçienca e Energjisë

ESCO - Kompani për Shërbime Energjetike

FEE - Fondi i Efiçencës së Energjisë

MEI – Ministria e Energjisë dhe Industrisë

MZHU – Ministria e Zhvillimit Urban

PKVEE - Plani Kombëtar i Veprimeve i Efiçencës së Energjisë

TKE - Traktati i Komunitetit të Energjisë

Hyrje

Shqipëria është e vendosur të hyjë në BE si anëtare me të drejta të plota. Anëtarësimi kërkon miratimin e *Acquis* të BE-së në të gjitha aspektet e çështjeve sociale dhe ekonomike, përfshirë energjinë dhe mjedisin. Strategjia aktuale e BE-së e vlerëson efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, si një prioritet për zhvillimin ekonomik dhe të përgjithshëm të çdo vendi¹. Si anëtarë të Komunitetit të Energjisë dhe angazhimeve të tjera të marra prej saj², Shqipëria është e angazhuar për të ndjekur këtë prirje duke adoptuar legjislacionin në përputhje me *Acquis* të BE për Efikasitetin e Energjisë, Energji të Rinovueshme etj, dhe të përgatisë periodikisht Planet Kombëtare të Veprimit, monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e objektivave të energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë dhe reduktimit të emetimeve të gazrave me efekt sërë. Objektivi konkret afatmesëm i vendosur nga Qeveria Shqiptare në këtë kontekst, është ulja e konsumit të energjisë prej 9% deri në vitin 2018.

Në zbatim të këtyre detyrimeve, në nëntor 2015 Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 124 dt. 05.11.2015 "Për efikasitetin e energjisë"³, si mekanizëm për transpozimin e Direktivës 2012/27 të BE "Për Efikasitetin e Energjisë"⁴, si hap të parë drejt transpozimit të plotë të direktivave të BE-së për efikasitetin e energjisë. I botuar në Fletoren Zyrtare numër 201, të 24 nëntor 2015⁵, ky ligj ka hyrë në fuqi në 9 Dhjetor 2015 duke parashikuar që të sillte rezultatet e para dhe ngritjen e institucioneve të reja brenda 12 muajve në vijim.

Ky studim i shkurtër fokusohet në identifikimin e objektivave të legjislacionit të efikasitetit të energjisë, veçanërisht të ligjit të Efikasitetit të Energjisë dhe synon të zhvillojë një analizë koncize mbi sfidat dhe mundësinë për arritjen e këtyre objektivave si dhe të propozojë hapat që duhen ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm për të plotësuar këto objektiva.

¹ The Energy Community Legal Framework , Special Edition on Energy Efficiency - May 2016 - https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/4172382/343359B931EF25C0E053C92FA8C0D3CC.pdf

² Western Balkan Sustainability Charter - July 2016, Paris - <http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/policy-highlights/regional-cooperation/20160713-03.western-balkan-sustainable-charter.pdf>

³ Ligji Nr. 124 dt. 05.11.2015 - https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_124_dt_12_11_2015_24797_1-1.pdf

⁴ Direktiva 2012/27 amendon direktiven 2010/30 "Per bartjen e shënimit me anë të etiketimit dhe informimit standard të produktit në lidhje me konsumin e energjisë dhe burimeve tjera nga ana e produkteve relevante për konsumin e energjisë" dhe shfuqizon direktiven 2006/32 "Per efikasitetin e perfundimit fundor te energjise dhe sherbimet energjitike"

⁵ Fletorja Zyrtare, nr. 201 - http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/201-2015.pdf

Analiza e problemit

Objektivi kryesor i ligjit "Për efikasitetin e energjisë" është hartimi i rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimit e përdorimit efikas të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë; vendosja e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë; dhe rritja e konkurrueshmërisë së operatorëve.

Në vetë relacionin shoqëruar të tij të paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, nënvizohet fakti se "një ligj i mëparshëm i miratuar në vitin 2005 për efikasitetin e energjisë nuk gjeti zbatim, për disa shkaqe kryesore, të tilla si :

- nuk u parashikua ndarje e qartë e përgjegjësiwe institucionale për monitorimin dhe zbatimin e ligjit;
- shumica e akteve nënligjore të parashikuara nga ky ligj nuk dolën asnjëherë dhe disa nuk janë miratuar;
- ligji nuk gjeti mbështetje institucionale për ngritjen e kapaciteteve teknike;
- nuk u miratua Fond i Efikasitetit të Energjisë siç e përmbajnë dispozitat e ligjit.

Për të shmangur të gjitha problematikat e hasura nga ligji i 2005-s, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, synoi që projektligji i ri të trajtonte qartësisht politikat e efikasitetit të energjisë, si p.sh. qëllimi, objektivat kombëtarë si kërkesë e acquis, politikat për efikasitetin e energjisë, miratimi dhe monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë (PKVEE), efikasitetin e energjisë në sektorët publikë & privatë (Rezidencialë, shërbime, industri, transport dhe bujqësi), bazë e të dhënave, matja, informacioni & trajnimi, auditimi, audituesit, shoqëritë e shërbimeve energjetike, Fondin e Efikasitetit të Energjisë, sanksionet etj. Ligji synon të gjejë zbatim për shoqëritë e prodhimit dhe të transformimit të energjisë, shoqëritë e shpërndarjes së energjisë, shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, konsumatorët fundorë, siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë⁶.

Gjithashtu, ndryshe nga legjislatiioni i vitit 2005, është përcaktuar që legjislatiioni mbi efikasitetin të ndahet në dy ligje tashmë, në ligjin për efikasitetin dhe atë për "Performancën Energjetike të Ndërtesave". Në momentin e zhvillimit të këtij studimi, ky projektligj i dytë, ai mbi performancën energjetike, është dorëzuar në Kuvend në pritje të shqyrtimit nga komisionet përkatëse (zotimi pranë Komunitetit të Energjisë në Vjenë kishte përcaktuar muajin qershor si afat të miratimit të ligjit). Nga një vështrim i detajuar i neneve të ligjit, vihet re që zbatueshmëria e këtij ligji varet në masën më të madhe nga Agjensia për Efikasitetin e Energjisë, e cila sipas dispozitave të vetë ligjit duhet të krijohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe deri në periudhën e krijimit të AEE, Ministria e Energjisë është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky

⁶ Relacioni shoqëruar i projektligjit "Për Efikasitetin e Energjisë" paraqitur në Kuvend - https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/relacion_-_eficenca_e_e_energjisë.pdf

ligj, përfshirë dhe përgatitjen e kuadrit ligjor që mundëson krijimin e AEE. Por ky nuk është i vetmi afat që rrezikon të shkelet nga kalendari i përcaktuar në ligj për miratimin e akteve nënligjore dhe institucioneve përkatëse, të cilat do të bëjnë të mundur zbatimin e tij.

Në tabelën më poshtë përshkruhen afatet e përcaktuar në këtë ligj.

TABELA E AFATEVE

Neni 27: **Brenda 12 muajve** nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet institucionet përkatëse për të miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

Këshilli i ministrave		Ministria e Energjise	
Nenet	Detyrat	Nenet	Detyrat
7, pika 1	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë hartohet nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.	Neni 18, pika 5	Sherbimet energjitike - Ministri, me propozimin e Agjencisë së Efiçencës së Energjisë, miraton kontrata standarde për shërbimet energjetike, të siguruar në kuadrin e një programi të financuar nga Fondi i Efiçencës së Energjisë.
Neni 10, pika 4	4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë, kushtet, dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.	Neni 15, pika 4	Informacioni dhe trajnimi - Ministri miraton një udhëzim mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit që do të vihet në dispozicion nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, siç parashikohet nga ky nen.
Neni 17, pika 4	Audituesi energjitik - Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit e të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet licenca e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.	Neni 14, pika 3	Matja - Ministri, me propozimin e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, miraton një udhëzim për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike, siç parashikohet nga ky nen.
Neni 18, pika 3	Sherbimet energjitike - Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit për shoqëritë, të cilave u lëshohet licenca e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.	Neni 13, pika 8	Baza e të dhënave të energjisë - Ministri miraton formën dhe afatet e paraqitjes së të dhënave dhe informacionit, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 20, pika 4	Fondi i Efiçences - Kriteret për emërimin e Këshillit Drejtues dhe të Drejtorit Ekzekutiv, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.	Neni 8, pika 3	Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë - Forma dhe shpeshësia e paraqitjes së raportimit mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përcaktohen me urdhër të ministrit.
Neni 25, pika 1	Agjencia për Efiçencën e Energjisë - Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, krijon Agjencinë për Efiçencën e Energjisë, si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë, dhe përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.	Neni 5, pika 5	Politikat e efiçencës së energjisë - Ministria përgjegjëse për energjinë, me mbështetjen e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, harton politikat kombëtare për efiçencën e energjisë, si dhe monitoron zbatimin e këtyre politikave.

Ministria e Zhvillimit Urban	
Nenet	Detyrat
Neni 16, pika 8	Auditimi energjetik - Formatit i auditimit energjetik dhe pagesa për audituesin energjetik përcaktohen në rregulloren e hartuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë dhe të miratuar nga ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin.

Tabela 1 - Detyrimet që rrjedhin nga ligji Nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë", Fletorja Zyrtare numër 201, botuar me 24 nëntor 2015.

Duke iu referuar tabelave të afateve të vendosura nga vetë hartuesit e ligji, në momentin e përgatitjes së këtij studimi, kur kanë kaluar mbi njëmbëdhjetë muaj nga hyrja në fuqi e dispozitave të tij, situata e hartimit të akteve dytësore paraqet vonesa të theksuara. E njëjta situatë me shkelje të afateve konstatohet edhe në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga ligji. Për të analizuar situatën, autorët e studimit zhvilluan takime informuse me personat përgjegjës për efiçencën e energjisë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) si dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përkatesisht z. Gjergj Simaku, Drejtor i Efiçencës së Energjisë dhe Burimeve të Rinovueshme në MEI dhe znj. Alma Saraçi, shefe e Sektorit të Efiçencës së Energjisë në AKBN. Më poshtë jepen të detajuara realizimi i deritanishëm i detyrave që lindin nga ligji, bazuar mbi informacionin e dy funksionarëve të mësipërm.

Krijimi i Agjensise se Efiçencës së Energjise (AEE) - Drejtoria e Efiçencës pranë MEI ka përgatitur aktualisht strukturën e Agjencisë, përfshirë përshkrimin e punës për cdo anëtar të stafit, nevojën për buxhetin vjetor, statutin dhe po identifikohen ambjentet ku mund të vendoset ky institucion i ri. AEE së bashku me agjensitë rajonale parashikohet të ketë

një staf prej 50 vetë. Zyrat e AEE parashikohen të vendosen në një godinë të ndërtuar ose rinovuar me masa të efikasitetit të energjisë. Kosto e parashikuar për realizimin e këtij qëllimi është rreth 40 milionë lek. Ndërkohë, nevoja për buxhetin vjetor të këtij institucioni për vitin 2017 është parashikuar të jetë rreth 1 milionë euro.

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (Dhjetor 2016)

Situata e zbatimit: Dokumentat e mësipërme janë paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi.

Fondi i Efikasitetit të Energjisë (FEE) - Në parashikimin e buxhetit për vitin 2017, Ministria e Energjisë ka parashikuar 12 milionë lek për Fondin. Burime të tjera financiare pritet të sigurohen nga donatorë të ndryshëm. MEI ka përgatitur VKM për kriteret për emërimin e Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv të Fondit si dhe statutin dhe manualin e procedurave të fondit.

Afati i përcaktuar në ligj: Brenda 12 muajve të parë (Dhjetor 2016)

Situata e zbatimit: Dokumentat e mësipërme janë paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi.

Plani Kombëtar i Veprimeve të Efikasitetit të Energjisë (PKVEE) - Drafti i PKVEE për periudhën 2016 - 2020 është përgatitur dhe po mbledhen komentet nga institucionet, të cilat janë të përfshira apo preken nga ky plan.

Nuk ka afat të përcaktuar në ligj për hartimin

Analiza e zgjidhjeve

Në mënyrë që të nisë zbatimin e Ligjit për Efikasitetin e Energjisë dhe masave të parashikuara për përmirësimin e situatës në këtë sektor, nevojitet që të përgatiten aktet nënligjore dhe kuadri përkatës rregullator. Situata e deritanishme e hartimit të këtyre akteve paraqitet në tabelën e mëposhtme. Sic mund të vihet re, është bërë një punë e kënaqshme nga hartuesit pranë dy institucioneve përgjegjëse MEI dhe AKBN, ndërkohë që kësaj shtese nuk i përgjigjet me të njëjtën shpejtësi edhe pjesa tjetër e institucioneve qendrore si Këshilli i Ministrave apo ministri të tjera të linjës. Këto vonesa rrezikojnë që të mbajnë pezull krijimin e institucioneve të reja (Fondin dhe Agjencinë) edhe për shumë muajt të tjerë përgjatë vitit 2017.

Tabela 2: Statusi i përgatitjes së akteve nenligjore të Ligjit për Eficienten e Energjisë deri në tetor 2016 (Falenderojmë për bashkëpunimin znj. Alma Saraçi – AKBN dhe z. Gjergj Simaku – MEI)

OBJEKTI	INSTITUCIONI	MIRATOHE T NGA	STATUSI (çfarë është bërë deri tani, kush janë hapat që duhen ndjekur, kur pritet të jenë gati)	KOMENTE
Hartimi/miratimi NEEAP	MEI	KM	<p>Është çuar draft VKM në KM. Pritet aprovimi i NEEAP. Me pas: Ngritja e një grupi pune të përbashkët për të ndarë detyrat sipas përgjegjësive dhe funksioneve të paracaktuara, vendosja e afateve për plotësimin e tyre, hartimi i raporteve periodike dhe paraqitja e tyre në grupin e përbashkët për të nxjerrë një raport përfundimtar të detajuar deri në detyrat e mbetura, shkaqet e mosrealizimeve, menyra për të përfunduar, etj.</p> <p>Zhvillimi i një database energjetik për çdo sektor të ekonomisë dhe për çdo burim të energjisë;</p>	<p>Detyrat që ka Shqipëria në kuadër të angazhimeve të ndermarra e bëjnë të domosdoshme përsheptimin e krijimit dhe të funksionimit të institucioneve në fushën e EE.</p> <p>Sikurse është e domosdoshme realizimi i zbatimit, vlerësimit dhe monitorimit të NEEAP ne cilesine e duhur.</p>
Menaxheri i energjisë (kategorite, kushtet, kërkesat e kualifikimit) (Neni 10/4)	MEI	KM	<p>Nuk ka zhvillime.</p> <p>Duhet: Përgatitja dhe trajnimi i menaxhereve të ardhshëm të energjisë, rritja e aftësive profesionale jo vetëm në fushën e energjisë, të teknologjive por dhe në ato mjedisore, në të gjitha fushat e ekonomisë. (ngarkesat e energjisë, kërkesat e konsumatoreve, etj)</p> <p>Licensimi i tyre -akreditimi</p>	<p>Ndoshta curricula e kualifikimit?</p> <p>Kriteret- mbi 5 vjet experience në fushën e inxhinjerisë së energjisë, me backgroundin perkates, pajisja me sistemet automatike të kontrollit dhe menaxhimeve energjetike;</p> <p>Duhet të jenë të pajisur me softëare që i shërbejnë menaxhimit të përdorimit energjetik</p>
Auditori i Energjisë (kategorite, kushtet, kërkesat e kualifikimit)	MEI	KM	<p>Pajisja me një rulebook që siguron të gjitha informacionin e nevojshëm për programet e auditimit që shërbejnë si një referencë për procesin e auditimeve.</p> <p>Trajnimi i audituesve; procesi i vlerësimit energjetik nëpërmjet auditimeve dhe procesi i rekomandimeve për masat për reduktimin e konsumit energjetik dhe kostot financiare për realizimin e tyre;</p> <p>pajisja me të gjitha aparaturnë dhe instrumentat e nevojshëm për realizimin e auditimeve;</p> <p>simulimet kompjuterike- sesi ndodh nënë kushtet më optimale</p>	<p>Curricula</p> <p>Nevoja dhe domosdoshmeria për zbatimin e projekteve për EE sjell nevojën për auditime dhe shërbime energjetike dhe lidhjen e kontratave midis audituesve të energjisë, ESCO-ve dhe konsumatoreve të mëdhenj energjitike;</p> <p>Rulebook që shërben si një udhërrëfyes ne procesin e auditimeve energjetike; hap pas hapi nga kryerja e auditimeve në të gjithë ndërtuesin, sistemet energjetike, pajisjet, etj deri në rekomandimin e masave të EE;</p>
Sherbimet Energjitike	MEI	KM	<p>Nuk ka zhvillime të kuadrit ligjor apo rregullator.</p> <p>Krijimi i tregut të shërbimeve energjetike në formën e kompanive ESCO, parashikohet të fillojë funksionimin me zbatimin e ligjeve mbi eficienten dhe performancën</p>	<p>Duke qenë se është licence e re (besoj) duhet të shtohet si lloj licence nga Ministria përgjegjëse dhe strukturat përgjegjëse për biznesin.</p>

			energjetike ne ndertesa.	Plotesim i kriterëve per perfitimin e licences per sherbimet energjetike Nevoja dhe domosdoshmeria per zbatimin e projekteve per EE sjell nevojen per auditime dhe sherbime energjetike dhe lidhjen e kontratave midis audituesve te energjise, ESCO-ve dhe konsumatoreve te medhenj energjitike;
Keshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv i Fondit (kriteret)	MEI	KM	Asnje zhvillim Krijimi i struktures per Fondin duhet brenda 6 mujorit te pare te 2017. Te hartohen: draft VKM per krijimin e struktures se re, draft struktura, kuadri rregullator. Kjo strukture ka per detyre kontrollin dhe menaxhimin e e Fondit dhe te siguroje perdorimin e tij ne perputhje te plote me qellimin per te cilin eshte krijuar. Kjo strukture ka per detyre te perfaqesoje interesat e te gjithë aksionereve ne perputhje me nje plan te percaktuar dhe miratuar. Sigurisht, vendimet merren ne menyre te perbashket ne perputhje me ligjet dhe rregulloret per EE. Perfituesit nga FEE mund te jene nga sektori privat, bashkite, sektori publik, sektori residencial, etj.	Krijimi i kesaj strukture duhet te behet ne kohen e duhur per tu mos u bere pengese per zbatimin e kuadrit ligjor per EE dhe financimin e tyre per prjekte te identifikuar nga AEE. Nje arsye tjetër është për mbarevajtjen e funksioneve të kesaj strukture duhet bere ne kohen e duhur parashikimi i buxhetit te nevojshem dhe sigurimi i donacioneve, granteve, taksave, etj nga burime jashte buxhetit te shtetit. Kriteret e personave qe do te punesohen duhet ti nenshtrohen statusit per nenpunesit civil dhe sigurisht te jene ne perputhje me detyrat qe do te kete kjo strukture. Qellimi i financimit te investimeve bazohet ne projekte te financueshme (bankueshme) dhe qe kane si objektiv permiresimin e EE dhe reduktimin e emetimeve ne atmosfere. Hartimi i raporteve periodike per te evidentuar perdorimin e fondeve dhe rezultatet e rrjedhura nga keto financime. Publikimet mbi efektet e financimeve ne menyre per ti sherbyer rritjes se vetedijes se konsumatoreve per perfitimet nga investimet per EE.
Agjensia per Efiçencen e Energjise (Organizimi, Funksionimi, Statuti, Buxheti etj)	MEI	KM	Jane pergatitur draftet e VKM per krijimin e AEE, rregullorja e institucionit (statuti), argumentimi per buxhetin e nevojshem. Draft organigrama e miratuar nga ministri do te jete bashkengjitur.	Pershpejtimi i procesit te krijimit te AEE do te krijojë te gjithë bazen e nevojshme institucionale dhe ligjore per zbatimin e kuadrit ligjor per EE ne kohen dhe ne vendin e duhur. Elemente te tille si: politikat energjetike,

			Ne fillimin e vitit 2017, do te jete e krijuar AEE dhe funksionimi i saj. AEE eshte perceptuar te funksionoj se bashku me zyrat rajonale te energjise te krijuara per grup rrethet me te medhaja te vendit.	auditimet, certifikimet dhe financimi i projekteve, vleresimi i NEEAP dhe monitorimi i tij kerkojne ne menyre te menjehershme funksionimin e institucioneve te ideuara per kete qellim.
Politika Kombetare e EE dhe Monitorimi i zbatimit te ketyre politikave	MEI, AEE	MEI,	Kuadri ligjor dhe rregullator per EE (dy ligjet), Plani Kombetar i EE, institucionet pergjegjese per hartimin e politikave dhe per monitorimin e procesit per EE do te jene pergjegjesi e MEI, AEE, MZHU.	Raportet periodike dhe vjetore te detyrueshme do te tregojne dhe panoramen ekzistuese, arrijten ose jo te objektivave/targeteve te vendosura, barrierat, pergjegjesite, etj.
Metodologjia per monitorimin e NEEAP (llogaritjen e kursimeve)	MEI, AEE	MEI,	Draft metodologjia per llogaritjen e kursimeve nga zbatimi i NEEAP, akoma e pa miratuar.	Miratimi me Vendim te Ministrit ose me VKM i Platformes MVE te pergatitur nga GIZ ORF-EE (bottom-up)
Shpeshtesia e kryerjes se monitorimit	MEI, AEE	MEI		
Formati dhe afati per bazen e te dhenave te energjise	MEI, AEE	MEI,	Nuk jane pergatitur formatet per mbledhjen dhe evidentimin e te dhenave gjate procesit te auditimeve apo monitorimit per EE.	
Rregullat e percaktimit te konsumit te energjise termike	MEI, AEE	MEI		
Lloji dhe periodiciteti i informacionit mbi EE qe do te vihet ne dispozicion nga AEE	MEI, AEE	MEI,	Pergatitja e formulareve qe do te plotesohen per sigurimin e informacioneve ne cdo sektor dhe per cdo burim energjetik do te jene ne varesi te konsumatoreve dhe aktiviteteteve te tyre. Periodiciteti raportimeve do te jene tre mujore dhe raporti final nje vjetor.	Bashkepunimi me INSTAT dhe AEE duhet te jete i ngushte. Zyrat rajonale ne funksion te AEE dhe ne baze te formulareve qe do te pergatiten duhet te plotesohen ne perputhje me qellimin e sigurimit te informacioneve te nevojshme per monitorimin. Cilesia e informacionit te siguruar dhe respektimi i afateve per sigurimin e informacioneve.
Kontrata standarte per sherbimet energjitike (ne kuader te fondit te EE)	MEI	MEI, MZHU	Nuk kemi akoma nje profil te miratuar te kontratave per sherbimet energjetike.	Duhet punuar per pergatitjen e kontratave tip ne menyre qe te kemi respektim te cilesise se sherbimeve, respektimin e afateve dhe evidentimin e qarte te kursimeve te realizuara dhe per rrjedhoje eliminimin e mosmarreshjeve te mundeshme.
Rregullorja per formatin e auditimeve energjitike dhe pagesa e auditoreve	MEI, AEE	MEI, MZHU	Nuk eshte miratuar rregullorja. Po punohet per hartimin e rregullores.	

Disa nga arsyet që konsulentët mundën të identifikonin për këto vonesa të paraqitura në tabelën më lart:

1. Konstrukti institucional aktual (MEI dhe AKBN) është i pamjaftueshëm për të bërë të mundur realizimin në kohë të të gjitha detyrave që u ngarkohen;
2. Mbështetja nga donatorët në këtë fushë ka qenë e mangët si me ekspertizë po ashtu dhe me fonde;
3. Një pjesë e akteve janë lënë me të drejtë për t'u përgatitur nga Agjensia për Efiçencën e Energjisë pas krijimit të saj;
4. Mungesë e vullnetit politik nga nivele vendimmarrëse për të bërë të mundur implementimin e plotë të ligjit të Efiçencës së Energjisë, për shkak të fokusimit në agjenda dhe sektorë të tjerë.

Rekomandime

Zbatimi në praktikë i legjislacionit të miratuar mbi standartet më të mira evropiane vazhdon të mbetet një sfidë jo vetëm në fushën e energjisë për vendin tonë. Në vijim të kësaj eksperience negative, përtej vonesave të vërejtura më lart në hartimin e akteve nënligjore të ligjit për efiçencën e energjisë, nevojitet që të vendoset theksi më tej edhe tek sfidat e zbatimit të tij në praktikë në të ardhmen.

Problematikat e vërejtura në implementim të legjislacionit janë të shumta dhe me karakter të ndryshëm, megjithatë shumica e tyre mund të klasifikohen në njërin prej grupeve vijuese:

1. Sfidat që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe respektivisht cilësinë e vetë akteve ligjore;
2. Sfidat që kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve për adresimin e të gjitha kërkesave që dalin nga aktet ligjore.

Sfidat e grupit të parë rezultojnë nga mostrajtimi i çështjeve të rëndësishme, nga adresimi joadekuat i tyre dhe nga formulimet joprecize ose dykuptimëshe për çështje esenciale të fushave të kanë të bëjnë me EE. Në këtë grup të sfidave bëjnë pjesë gjithashtu vështirësitë që rezultojnë nga trajtimi i parcializuar i një fushe të caktuar nëpër dokumente të ndryshme ligjore dhe si rezultat i mosreferimit, përkatësisht referimit të cunguar të dokumenteve relevante⁷.

⁷ Ndikimi i mekanizmave financiarë për Efiçencë e Energjisë Avni Sfishta - Qershor 2016 - <http://www.pips-ks.org/documents/20160707130804446.pdf>

Sfidat e grupit të dytë, ato që kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve, janë sfidat të cilat rezultojnë nga fakti që shpeshherë për zbatimin e një akti të caktuar ligjor nevojitet ngritja e institucioneve të reja, zhvillimi i kapaciteteve përkatëse humane si dhe shpeshherë ndryshimi i politikave fiskale dhe atyre financiare.

Përballja me sukses e këtyre sfidave përpos përkushtimit institucional, organizimit të mirë dhe bashkëpunimit ndërinstytucional kërkon edhe mbështetje serioze buxhetore. Nga zhvillimet e dekadës së fundit është dëshmuar që sfidat më serioze për institucionet në rrugën e zbatimit të politikave të Efiçencës janë pikërisht sfidat e këtij grupi.

Bazuar mbi këto problematika që ndeshen edhe në vende të tjera, Bashkimi Evropian ka krijuar një varg mekanizmash për t'iu ofruar asistencë, por edhe për t'i monitoruar përpjekjet e vendeve aspiruese për krijimin e kornizës përkatëse ligjore dhe harmonizimin e saj me vendet e BE-së. Rolin e institucionit asistues dhe monitorues në fushën e politikave energjetike e luan Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me seli në Vjenë. Gjithashtu asistenca teknike e GIZ-ORFEE për Ministrinë e Energjisë, mund të jetë e vlefshme për hartimin e metodologjisë për monitorimin, vlerësimin dhe verifikimin e kursimeve të energjisë, si rezultat i zbatimit të masave të planifikuara të efiçencës së energjisë.

Me qëllim përballjen e të gjitha këtyre sfidave për hartimin e akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara, ngritjen e institucioneve të parashikuara si dhe krijimin e premisave për zbatimin e masave të parashikuara për efiçencën e energjisë rekomandohet që:

- Të shtohen burimet njerezore vendase dhe të nxitet përfshirja e ekspertizës së huaj nëpërmjet donatorëve, për plotësimin e të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve të tjera, të cilat mbajnë pezull ngritjen e institucioneve të reja dhe nisjen e zbatimit të ligjit për Efiçencën e Energjisë. Përfshirja e ekspertëve nga bota akademike apo biznesi privat në hartimin e këtyre dokumentave rregulluese të nivelit të dytë, mund të jetë një tjetër mundësi për përshpejtimin e agjendës dhe arritjen e afateve të parashikuara.
- Kërkohet një angazhim më i madh i vendimmarrësve në institucionet qendore (Këshilli i Ministrave, Ministria e Energjisë, Ministria e Zhvillimit Urban etj) dhe bashkërendim mes tyre për të çuar përpara agjendën dhe detyrimet e përcaktuara nga ligji. Për shkak të fokusimit tek reforma në sektorë të tjerë, ka një mungesë të vëmendjes së duhur për fushën e Efiçencës së Energjisë. Ngritja e grupeve ad-hoc ndërinstytucionale me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë në këtë sektor, mund të nxisë kapërcimin e këtyre vonesave dhe neglizhencave nga vendimmarrësit.
- Mbështetja financiare në buxhetin e vitit 2017 për ngritjen e Fondit të Efiçencës dhe Agjensisë për Efiçencën, është parashikuar në nivele mbijetese për logjistikën dhe buxhetin e pagave për këto institucione, duke lënë jashtë vëmendjes çdo

mbështetje tjetër për investime nga subjekte të tjera apo veprimtarinë e parashikuar në sigurimin e masave të kursimit të energjisë. Në këto rrethana, është e domosdoshme që mbështetja e nevojshme financiare të plotësohet nga financimet e organizmave ndërkombëtare donatorë dhe institucionet e ndryshme financiare private. Angazhimi i këtyre burimeve dhe mekanizmave të tjerë financiare rajonale dhe evropiane kërkon një angazhim serioz nga politikëbërësit dhe Këshilli i Ministrave.

- Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të agjendës së Efiçencës së Energjisë do të ndihmonte në nxitjen e respektimit të afatave ligjore dhe presionit pozitiv për të gjithë aktorët e ngarkuar nga ligji. Ky monitorim nuk mund të lihet në dorë vetëm të organizmave ndërkombëtarë si Komuniteti i Energjisë, por kërkon një angazhim të vazhdueshëm të programeve të donatorëve dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Bibliografi

- **Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2010-2018** -
https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/1138177/0633975AB4E57B9CE053C92FA8C06338.PDF
- **Legjislacioni i Efiçencës së Energjisë në Komunitetin e Energjisë – Maj 2016** -
https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/4172382/343359B931EF25CE053C92FA8C0D3CC.pdf
- **Kapitulli i zhvillimit të qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor – Paris, korrik 2016** -
<http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/policy-highlights/regional-cooperation/20160713-03.western-balkan-sustainable-charter.pdf>
- **Takimi i 11-të i grupit të koordinimit të Komunitetit të Energjisë – Qershor 2016** -
https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/4230391/37A8D687363B3198E053C92FA8C0DBF5.pdf
- **Ligji "Për Efiçencën e Energjisë" Nr. 124 dt. 05.11.2015** -
https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_124_dt_12_11_2015_24797_1-1.pdf
- **Relacioni shoqërues i projektligjit "Për Efiçencën e Energjisë" paraqitur në Kuvend** –
https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/relacion_-_eficenca_e_e_energjise.pdf
- **"Ndikimi i mekanizmave financiarë për Efiçencë e Energjisë", Avni Sfishta - Qershor 2016** - <http://www.pips-ks.org/documents/20160707130804446.pdf>